URDHËR
Nr. 1056, datë 5.12.2024

PËR DISA MASA MBROJTËSE NDAJ SËMUNDJES SË INFLUENCËS AVIARE ME PATOGJENITET TË LARTË TË SHPENDËVE TË SHFAQUR NË SHTETIN E TURQISË

Mbështetur në nenin 102, pika 4 të Kushtetutës, nenin 43, të ligjit nr. 10465, datë 29.9.2011, "Për shërbimin veterinar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar,

URDHËROJ:

1. Ndalimin e importit, tranzitimit nëpërmjet territorit të Republikës së Shqipërisë, të:
a) shpendëve të gjallë shtëpiakë;
b) zogjve 24-orësh;
c) shpendëve dekorativë;
ç) materialit biologjik të shpendëve;
d) vezëve të shpendëve;
dh) mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht;
e) nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht,
nga shteti i Turqisë, sipas tabelës së mëposhtme:

Ndarja administrative e nivelit 1	Ndarja administrative e nivelit 2	Ndarja administrative e nivelit 3
Konya	**Selçuklu (Meram)***	
Afyon	**Merkez***	
Konya	**Çumra***	
Konya	**Karatay***	
Afyon	**Bolvadin***	

Shënim. Simboli (*) nënkupton zonën e infektuar që bllokohet.

2. Certifikata veterinare të garantojë origjinën e ngarkesës së ardhur.

3. Autoriteti Kombëtar i Ushqimit të informojë rregullisht Drejtorinë e Përgjithshme të Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit dhe Autoritetin Kombëtar të Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve, për çdo ngarkesë të shpendëve të gjallë shtëpiakë, zogjve 24-orësh, shpendëve dekorativë, materialit biologjik, vezëve të shpendëve, mishit të shpendëve të patrajtuar termikisht dhe nënprodukteve të shpendëve të patrajtuar termikisht që vijnë nga vendet e sipërcituara në pikën 1.

4. Urdhri nr. 982, datë 19.11.2024, "Për disa masa mbrojtëse ndaj sëmundjes së influencës aviare me patogjenitet të lartë të shpendëve, të shfaqur në shtetin e Turqisë", shfuqizohet.

5. Për zbatimin e këtij urdhri ngarkohen Drejtoria e Përgjithshme e Zhvillimit në Fushën e Sigurisë Ushqimore, Veterinarisë, Mbrojtjes së Bimëve dhe Peshkimit, Drejtoria e Politikave Veterinare, Autoriteti Kombëtar i Veterinarisë dhe Mbrojtjes së Bimëve dhe Autoriteti Kombëtar i Ushqimit.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

MINISTËR I BUJQËSISË DHE ZHVILLIMIT RURAL
Anila Denaj